




AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

KORRIK - SHTATOR 2020

Revista e AIDA-s, newsletter, është botim i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

AIDA ka si qëllim që me anë të këtij botimi të informojë në mënyrë të vazhdueshme publikun dhe bizneset për aktivitetin e agjencisë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), sjell për publikun, biznesin dhe palët e interesit, revistën periodike Newsletter për periudhën Korrik– Shtator 2020.

Në këtë Newsletter do të gjeni informacione rreth aktivitetit të Agjencisë për tre mujorin e tretë të vitit 2020, takimet e organizuara duke respektuar rregullat e vendosura nga Qeveria Shqiptare në këtë periudhë pandemie, webinarët e zhvilluara, rubrikat e publikuara në faqen web, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, etj.


AIDA në përshtatje edhe me situatën e krijuar nga COVID -19 ka vazhduar të jetë proaktive dhe në dispozicion me të gjitha shërbimet dedikuar bizneseve dhe palëve të interesit. Për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve AIDA ka nisur fushatën më të re promovuese 'E Dua Shqip' në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve 'Made in Albania'. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës.

Gjithashtu në web vazhdon të përditësohet rubrika "COVID-19", një rubrikë e cila ka si qëllim aksesin në informacion dhe qarkullimin e këtij informacioni në një kohë sa më të shpejtë për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u informuar mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve na vizitoni në:

 info@aida.gov.al

 aida.gov.al

 +355 (0)42 251 001


 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

 [AIDA - Albanian Investment Development Agency](https://www.facebook.com/AIDA-Albanian-Investment-Development-Agency)

SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju kujton që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm dhe të respektojmë masat parandaluese kundër COVID-19. Sot më shumë se çdo ditë ka nevojë për solidaritet.



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al
 tel: +355 042 251 001
 web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare.

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare, nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al ose pranë zyrave të AIDA-s duke u lidhur më parë me stafin tonë.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale për përditësime.

AIDA Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ka në fokus promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues vendas, si edhe promovimin e potencialit turistik kombëtar.

Gjithnjë e më shumë AIDA po synon gjetjen e qasjeve të reja në funksion të përmirësimit të shërbimeve që ofron. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet objektivave konkrete të vendosura për vitin 2020 nga secila drejtori, duke ndërthurur punën e përbashkët profesionale si institucion drejt një qëllimi.

Më rëndësi për punën e AIDA-s gjatë vitit 2020 është mbështetja konkrete ndaj biznesit vendas, thjeshtimi i procedurave për investitorët e huaj; vendosja e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimi i informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimi i disa "outreach campaign" në sektorët potencialë, realizimi i disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t'u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.



invest in Albania



FUSHATA MË E RE NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE 'MADE IN ALBANIA'

AIDA, shërben si një pikë qendrore për sipërmarrjet dhe është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën "Made in Albania", duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale.

E Dua Shqip është fushata më e re promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve 'Made in Albania'.

Qëllimi ynë është që të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T'i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t'i prezantoni dhe t'i ktheni në një "atraksion turistik" për vendin e origjinës, na dërgoni një përshkrim dhe një foto të produktit.

Rrënjët janë të rëndësishme.

Kjo nismë kërkon bashkëpunim, besim dhe interes, prandaj nëse interesoheni të jeni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



Kravata 3D

Sallon i parë i modës në Tiranë, Onus Maison filloi rugëtimin e tij në vitin 1927 për hartimin dhe krijimin e veshjeve të modës së lartë duke përdorur pëlhurat më të mira që do ti rezistonin kohës. Marka prestigjioze Onus, sot e shoqëruar me inovacionin sjell prezantimin e kravatave të famshme 3D. Mënyra e pafund për t'u shprehur përmes një koleksioni unik plotësisht të personalizuar të punës së dorës dhe printimeve 3D.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Onus Maison: viptie@3b-army.com ose në 0674017017.



Kostum Popullor i Beratit

Zakonet dhe traditat e jetës shqiptare janë trashëguar të pasqyruara në krijimtari të popullit. Kostumi tradicional i Beratit, i qëndësuar me fije ari, i punuar me gjilpër me dorë të lirë, mund të cilësohet pa frikë si një kryevepër, vlera e të cilit rritet sa më shumë që koha kalon.

Në qytetin e Beratit, qëndistari Albana, sipas porositje sjell në treg këtë produkt të veçantë dhe original, tërësisht punim dorë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Qëndistari Berati: albana.balaj@hotmail.com ose në 0694588313.



Vaj Ulliri 'Subashi'

Në Mal-Subash, në zonën e Marikaj, gjenden ullinjtë qëndruarë kalinjtë, të pasur me vlera ushqimore.

Familja Subashi me traditën e vjetër të mbledhjes dhe përpunimit të ullit, përgatit vajin e ullitit ekstra të virgjër 'Subashi', unik për shijen dhe aromën e tij të mirëkultureshme.

Vajin e ullitit ekstra të virgjër 'Subashi' mund ta gjeni në Kalanë e Tiranës, ose ta kontaktoni në numrin 0684094211 dhe në adresën e email: silvana_pinari@yahoo.com.



Mjaltë Gështenje

Në zonën e Korçës, blerët me lulëve të gështenjës, mbledhin nektarin e ëmbël për mjaltin e shijshëm dhe kurues të gështenjës.

Ngjyra e tij e veçantë, e erët dhe aroma e drunjtë, i japin mjaltit një shije të pakrahueshme. Mjalti i gështenjës 'Morava' është një burim i shkëlqyer i proteinave dhe mineraleve.

Mjaltin 'Morava' mund ta porosisni në numrin e telefonit 0692055580 ose në adresën e email info@mjalte-morava.com.



Trahana "Lunxheria"

Tani është verë, por në verë përgatiten zahirët e dimrit. Mo diellin e rrehtë të verës i bëjmë gatë që ato të jetojnë gjatë.

Në krahinën e Lunxhërisë, duke ruajtur traditën lunxhërore përgatitet me dashuri trahanaja e thartë, një ushqim shumë i shëndetshëm. Kompania Lunxhëria sigurohet që të sjell cilësinë më të mirë në treg, duke mos humbur shijen unike të prodhimeve vendëse.

Zgjidh tänden, kontakto me kompaninë Lunxhëria në: trahanalunxheria@gmail.com ose në 0693590672.



Gjalpë Lajthie

Gjalpi i lajthië ka sasi të larta vitaminë E, B1 dhe B6, magneziumi dhe fosforin. Lajthia gjithashtu ka sasi të larta antioksidantësh që ndodhen kryesisht në lëkurën e lajthive.

Kompania "Pemla" ofron 100% produkt vendas dhe të sigurt në përdorim. Është i këshillueshëm për personat me kolesterol të lartë në gjak dhe inflamacion.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Pemla: info@pemla.al ose në 0692925333.



Vera Saze

Vera Saze merr frymëzimin e saj nga Ansambli Saze, muzika e të cilit buron nga një instrument i lashtë tradicional në zonën e Përmetit - ashtu si dikur Debina e Bardhe për të bërë këtë verë.

Debina e Bardhe, një larmi autoktone në Shqipërinë Jugore dhe veçanësisht e ritur në Përmet, është korrur me dorë nga vendasit në një lartësi prej 250 metra përgjatë lumit Vjosa.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Wine Society; wine.society.al@gmail.com ose në 0683030005.



Sapun Artizanal

Në fshatin Shtoj, në Shkodër prodhohet sapuni natyral artizanal me vavra dhe bimë nga vendi ynë. Ky produkt është 100% natyral, pa përmbajtje kimikatesh dhe si njëdhjetë është miqësor me mjedisin.

Sapuni natyral artizanal njihet për vetitë e tij për një lëkurë të pastër dhe të shëndetshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Natyra ime; info@natyrame.al ose në 0672860849.



Bleta Shafran

Në Petrelë shumë pak minuta larg Tiranës që prej 3 vitesh në një fermë të vogël kultivohet bima e mrekullive, bima e shafanit. Shafani prodhohet në kushte tërësisht organike me një cilësi të lartë dhe është një thesar i vërtetë për organizmin tonë pasi ndihmon në forcimin e kujtesës, të zemrës dhe çetëson sistemin nervor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Bleta Shafran; bletashafran@gmail.com ose në 0692065921.



Gliko rrusi "Bonjo"

Tradita përmetare e përgatitjes së glikove vazhdon të ruhet me një kujdes të veçantë që nga viti 1995, nga punishja Bonjo, e cila me skapencionën e gjatë dhe cilësinë që ofron sjell glikonë e mrekullueshme të rushtit. Glikoja përpunohet nga fruta tërësisht bio, që mbledhen në zonën e Përmetit dhe përgatitet në mënyrë artizanale sipas recetave të gatimit të amvisive Përmetare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Gliko Bonjo; alsinbonjo@gmail.com ose në 0693340088; 0693211074.



Lëng Frutash "Eliksir"

Në çdo cep të Shqipërisë fermerët punojnë me dashuri tokën për të gëzuar pastaj prodhimin e tyre në tryezat e secilit. Kompania Kop Frut Dibër 2012, nisi rrugëtimin e saj për të bërë bashkë frutat e fermerëve dibronë.

Ajo prodhon lëngjet e frutave 100% bio, "Eliksir". Karakteristikë e këtyre produkteve është përmbajtja e tyre pa konservant, pa sheqer, pa ujë dhe pa asnjë element tjetër të shtuar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kop Frut Dibër 2012; kop.frut@gmail.com ose në 0693440444.



Gliko "Përmeti"

E kush nuk i njih glikotë o Përmetit? Glikotë e domateve jeshile dhe patëlxhamit me arra. Kompania gliko "Përmeti" ndjek traditat e trashëguara ndër vite për të sjellë një nga produktet më specifike, glikonë e arrës.

Kjo gliko dallohet për formën e bukur, shurupin e trashë dhe shijen e jashtëzakonshme. Ajo është një nga glikotë më kurative dhe me më shumë kohëzgjatje.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën, provoni Gliko "Përmeti"; krenamurce@yahoo.com ose në 0695152856.



zajdh të vendit

Sapuni "Bardha e Temalit"

Sapuni "Bardha e Temalit", një produkt 100% vegjetal, i prodhuar me ekstraktet më të veçanta të luleve bimore të maleve shqiptare. Kompania artisanale "Zana e Malit" inspiruar nga bimët tradicionale të maleve është kujdesur t' i shtojë tregut prodhime natyrale që trashëgojnë traditën e përkudësjes dhe bukurisë Shqiptare.

Sapuni përmban lule kamomili, vaj hudhre, tërshërë, lule kalendula, xhel aloe vera dhe rozmarinë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Zana e Malit: zanaemalit@zanamalit.al ose në 0672061644.



zajdh të vendit

Boronica

Në veri të Shqipërisë, në rrethin e Tropojës, në pyjet e larta të pishës e të ahut e deri në kullatat alpine, kompania "LEA-2011 shpk", mbledh për ju bimën e boronicës. Boronica ndihmon trurin dhe zemrën, mbroten sytë dhe lëkurën. Antioksidantët që gjenden te boronicat, sidomos ato që rriten të egër në tokat shqiptare, janë aq të forta sa janë të afta për të neutralizuar radikalët e liria që lidhen me zhvillimin e disa sëmundjeve kardiovaskolare apo tumorale.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në kompaninë "Lea-2011 shpk": lea2011shpk@gmail.com ose në 0694782045.



zajdh të vendit

"Vaj Borshi"

Në Rivierën Shqiptare, në fshatin e bukur të Borshit, në një territor të njohur që në lashtësi për mjetin e ullinjve qindrajqorë, kultivohet ulliri Kalinjot.

Kompania "O&B shpk" që prej vitit 2000 sjell në treg markën "Vaj Borshi" duke plotësuar standardet më të larta, që nga grumbullimi i ullinjve, pastrimi i tyre dhe deri tek teknologjia e përgunimit për daljen e një vaji cilësor për konsumatorit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në kompaninë O&B shpk: vaj.borshi@gmail.com ose në 0692094712.



zajdh të vendit

Çaj "Albanian Tea"

Albanian Tea, vjen në treg nga një punë e palodhur e njerëzve të cilët dashurojnë natyrën. Mbledhja e luleve dhe gjetheve të ndryshme përgjatë gjithë kodrave, fushave e luginave të Shqipërisë e bën çajin, një produkt të dashur për këdo, me varietete të pasura si çaj mali, kamomili, boronicë, shërbef etj.

Direkt nga natyra çaji kalon në procesin e tharjes së lules dhe gjetheve, pastrimit në mënyrë artisanale dhe paketimit të tij, duke sjell një produkt të pastër e plot aromë lulesh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Albanian tea në albaniantea1@gmail.com



zajdh të vendit

Lëng "Goji Berry"

Goji Berry, fruti që zgjat jetën. Në vite ky frut ka gjetur përdorim në mjekësinë popullore. Falë investimeve, bima goji është kultivuar dhe përpunuar në mënyrën më të shëndetshme nga kompania "Agrollina" me plantacione në zonën e Myzeqesë, për të sjellë në treg lëngun "Goji Berry".

Një lëng i freskët, i cili nuk i humbet vlerat e bimës, përmbanë vitaminën C, B2, A, hekur, selenium dhe antioksidantë të tjerë. Kompania synon eksportin e këtij lëngu. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Agrollina Group: info@agrollinagroup.com ose në 0692052616.



zajdh të vendit

Vera "Serina Rosé"

Vera "Serina Rosé" prodhohet nga përzgjedhja e rrushit autokton Serina i cili kultivohet në një klimë të freskët dhe shfaq cilësi të dallueshme të varietetit.

Metoda e veçantë e prodhimit dhe procesit të fermentimit dhe lëkurën e rrushit për një kohë të shkurtër, sjell këtë verë me ngjyrë rozë të lehtë dhe aromë tipike frutash.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Murallari: fatosmurellari@yahoo.com ose në 069 76 94 770.

Forum Diskutimi - Promovimi i Produkteve Lokale

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në kuadër edhe të fushatës 'Zgjidh të Vendit', organizoi një forum diskutimi me temë promovimin e produkteve lokale dhe forcimin e markës 'Made in Albania'.

Pjesë e këtij forumi ishin Z. Sokol Nano, Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, Z. Eduard Shalsi, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Znj. Frida Krifca, Drejtore e AZHBR, si edhe përfaqësues nga biznese dhe autoritete të tjera shtetërore dhe private.



Ky forum kishte si qëllim kryesor hapjen e diskutimeve me përfaqësues të sektorit të tregtisë për promovimin e produkteve shqiptare dhe forcimin e markës "Made in Albania" nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit të një rrjeti distributorësh që të tregtojnë produktet shqiptare.

Fjalën hapëse të forumit të diskutimit e mori Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s Z. Sokol Nano, ku theksoi rëndësinë e promovimit të produkteve vendase me qëllim zgjerimin e eksporteve dhe rritjen e sipërmarrjeve shqiptare edhe në nivel ndërkombëtar.



AIDA, gjatë pandemisë dhe jo vetëm, ka asistuar kompanitë me informacion dhe ka qëndruar pranë tyre me qëllim adresimin e problematikave. AIDA ka ndërmarrë së fundmi fushatën "Zgjidh të Vendit", një fushatë promovionale mbi promovimin e produkteve vendase të çdo qyteti dhe fshati duke bërë të njohur shumë produkte "Made in Albania".

Gjatë forumit u zhvillua edhe një sesion i hapur pyetje-përgjigje ndërmjet pjesëmarrësve të bizneseve, përfaqësuesve të panelit dhe autoriteteve të tjera shtetërore ku u diskutua mbi politikat që duhet të ndërmerren në mbështetje të produkteve lokale, për të rritur cilësinë dhe konkurrueshmërinë në vend, rajon dhe më gjerë.

TAKIME DHE VIZITA



Rivitalizimi i pronave shtetërore një nga prioritetet e AIDA-s

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s Z. Sokol Nano, vizitoi qytetin e Korçës në kuadër të identifikimit dhe promovimit të pronave shtetërore. Kjo vizitë u organizua me ftesë të kryetarit të Bashkisë Korçë Z. Sotiraq Filo.

Pronat shtetërore nuk duhet të flenë, por ato duhet të sillen në vëmendjen e investimeve për projekte të reja zhvillimi që ndihmojnë drejt-përdrejt zonën, qytetarët dhe biznesin, ky është qëllimi i AIDA-s, u shpreh Z. Nano gjatë takimit, proces në të cilin aktorët vendorë kanë një rol të rëndësishëm proaktiv.



Qeveria Shqiptare mbështetje strategjike për bujqësinë

“Agro Iliria Group” është bërë subjekt përfitues i statusit të investitorit strategjik. Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në cilësinë e Sekretarit të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), i dorëzoi personalisht investitorëve Z. Shpëtim Oseku dhe Z. Ilir Trebicka Vendimin e K.I.S. Nr. 6/9, datë 24.06.2020 në plantacionet me shegë dhe gojiberry në Karavasta.

Z. Nano theksoi se sot Shqipëria ka nevojë më shumë se kurrë për investime të tilla. Për këtë ai siguroi Z. Oseku dhe Z. Trebicka se AIDA, është në dispozicion të përmbushjes së plotë të funksioneve të saj përballë organeve shtetërore dhe investitorit, e pakursyer për të realizuar sa më mirë në afatet e parashikuara një prej projekteve më inovative në fushën e bujqësisë.



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në funksion edhe të veprimtarisë së saj ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit. Që prej mesit të muajit mars, vendi ynë është përballur me pandeminë e shkaktuar nga Covid-19. Masat e ndërmarra për kufizimin e transmetimit të pandemisë kanë dhënë ndikimin e tyre edhe në ekonomi. Si pasojë e situatës aktuale të pandemisë, sektori turizmit rezulton të jetë një ndër sektorët më të prekur ku shumë biznese janë duke u përballur me sfida të reja për të tashmen si edhe të ardhmen e zhvillimit të aktivitetit të tyre.

Duke qenë se turizmi në Shqipëri konsiderohet si një ndër sektorët kyç të zhvillimit ekonomik të vendit duke u pozicionuar si një ndër kontribuesit kryesor të zhvillimit të ekonomisë kombëtare si në terma monetarë, ashtu dhe në atë të punësimit, AIDA e ka mbështetur gjithmonë këtë sektor duke e promovuar vazhdimisht nëpërmjet nismave të ndërmarra.

Vizitë në Kantinën Çobo në Berat – Një ditë pranë të Kuqes së Onufrit

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në këtë periudhë pas pandemie e ka gjithë vëmendjen në promovimin e produkteve vendase dhe përkrahjen e turizmit kombëtar.

E Kuqja e Beratit dhe Kashmeri të mvesh me një shtresë të moçme vendase. Veçuan këto dy gjaqe mistike dhe artistike si përfaqësuese kuqezeza të traditës dhe shijes.

Në kantinën Çobo, jo vetëm shijuam, por edhe përjetuam biseda të ngrohta njerëzore, kuriozitet të shuara dhe të ndezura rishtaz për t'u kthyer prapë te "E Bardha e Beratit", si e bardha e një mbi një dritareve të Goricës dhe te e "E Kuqja e Beratit", si ajo e Onufrit, të birit të Nikollës, me aq varietet rrushi, sa tonalitete ka e kuqja deri te vishnja, në afresket e kishave të fshehura në Mangalem dhe Goricë.

Në linkun e mëposhtëm, ju ftojme të ndiqni pamje nga vizita e Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s, Z. Sokol Nano, vizitë në kuadër të njohjes së problemeve të sektorit të agroturizmit në vend dhe më së shumti në promovimin e këtij sektori kyç dhe rolit që ka në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë vendase. <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/663982591172258>



Vizitë në Kantinën Nurellari, zonja moderne e qytetit të bardhë

Kantina Nurellari e vendosur 10 km larg qytetit muze të Beratit, në fshatin Fushë-Peshtan, rrugës për në Çorovodë, është vendi ideal për të shijuar verën 100% shqiptare dhe pamjet piktoreske mes fushave, maleve kodrave dhe lumit Osum pak më tutje. E çdo të donim më shumë për të shijuar disa ditë vjeshte a dimri.

Kombinimi i klimës, tokës së pasur dhe pjellore, vendndodhjes gjeografike të kantinës, me vitet e njohurisë dhe përvojës së fituar, vijnë së bashku për të krijuar cilësinë dhe shijen unike të verërave Nurellari.

Kantina Nurellari së bashku me hotelin e kuruar me detajet e një shije të hollë e ndërtuar rishtas, mirëpret çdo vit mijëra turistë dhe vizitorë të pasionuar pas verës, të cilët degustojnë dhe shijojnë vizitat panoramike.

Në kantinën Nurellari prodhohen verëra nga varietete autoktone shqiptare të rrushit duke ndjekur filozofinë që prodhimi verës është në fillim pasion e më pas biznes.

Pulsi Beratit me një aromë shumëllojshmërie agrumesh të freskët, ku cilësia dhe niveli i njohurive teknike të krijimit e saj, ishin tepër të dukshme.

Serina Rose bërë nga rrushi i verës së kuqe, por me një shije dhe qartësinë e ftohtë të një vere bardhë.

Vera e Shenjtë, një krijim i butë, i bërë nga rrushi thatë me një shije të lehtë të frutave të freskëta.

AIDA është në mbështetje të agroturizmit. Potenciali i madh që ka vendi ynë në këto fusha janë frymëzim dhe stafi i Agjencisë është i motivuar që të promovojë dhe mbështesë investime të suksesshme, inovatore dhe guximtare, të cilat hapin rrugën për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe promovimit të vendit si destinacion i turizmit të eksperiencave në rajon edhe me gjerë.

Në linkun e mëposhtëm, ju ftojmë të ndiqni pamje nga vizita në Kantinën Nurellari.

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/327074645237877>



Durrës - Takime Door to Door me kompanitë Wine AL dhe Stella.

Stafi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Enterprise Europe Network -Albania (EEN-Albania) zhvilluan në qytetin e Durrësit takime “Door to Door” në kompanitë Wine AL dhe Stella Shpk.

Kompania Wine AL e themeluar në vitin 2015 me aktivitetet prodhimin e verës 100% produkt shqiptar, është ende në fazën e testimit dhe synon të nxjerr në treg një verë të një cilësie të lartë me qëllim eksportin e saj jashtë Shqipërisë. Kompania ka përfituar përmes shërbimeve dhe skemave të granteve që AIDA ofron në mbështetje të certifikimeve të produkteve dhe blerjes së pajisjeve teknologjike për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.



Kompania Stella Shpk me një eksperiencë 25 vjeçare në treg, operon në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të konfeksioneve. Aktualisht kompania ka filluar edhe prodhimin e produkteve spitalore, të cilat i eksporton në Evropë.

AIDA, në cilësinë e institucionit koordinues të projektit Enterprise Europe Network (EEN-Albania) prezantoi tek bizneset shërbimet dhe asistencën që EEN ofron në identifikimin e tregjeve të reja, si edhe në gjetjen e partnerëve të rinj ndërkombëtarë me synim rritjen e vlerës së shtuar të bizneseve.

Përfaqësuesit e kompanive shprehën interesin e tyre për të qenë pjesë e platformës EEN dhe për të përfituar nga të gjitha mundësitë që ofrohen për zhvillimin dhe promovimin e biznesit në nivel ndërkombëtar.



AIDA asiston kompanitë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

Zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë Belinda Ikonimi në një vizitë në kompaninë italiane “Innovaway” e cila operon në fushat: Menaxhimi i Shërbimit të IT-së, Teknologjia e Informacionit, Transferimi i Procesit të Biznesit (BPO).

Gjatë pandemisë Covid-19, kompania përshtati punën nga distanca dhe u fokusua në zhvillimin e sektorit të kërkimit dhe zhvillimit të aplikimeve software.

“Innovaway” numëron 80 të punësuar në Shqipëri dhe ofron shërbime për më shumë se 150 klientë në Itali dhe Europë, kryesisht për industrinë e modës, shitjeve me pakicë, transport, shërbime financiare e deri te shërbimet komunale të ofruara për administratën publike.

AIDA, si koordinator e Projektit Enterprise Europe Network në Shqipëri

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e koordinatorit të Enterprise Europe Network - Albania (EEN - Albania), nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Enterprise Europe Network - Kosovë (EEN-Kosovo).

Përmes kësaj marrëveshje EEN- Albania dhe EEN Kosovë do të bashkëpunojnë në kuadër të implementimit të aktiviteteve specifike si: Mbështetje dhe shërbime këshillimi për sipërmarrjet e të dy vendeve; Koordinim i shërbimeve profesionale individuale për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme; si edhe ofrimi i aksesit për të gjetur partner të mundshëm biznesi në të dy vendet; Bashkëpunim dhe organizim i aktiviteteve të ndërmjetësimit, misioneve të biznesit, panairove, si edhe aktiviteteve informuese për të lehtësuar bërjen e biznesit ndërkombëtar, rritjen e inovacionit dhe teknologjisë.



WEBINARE



“Turizmi i së Ardhmes - Menaxhimi në kohë reale post COVID-19”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi në datën 9 Korrik webinarin me temë: “Turizmi i së Ardhmes - Menaxhimi në kohë reale post COVID-19”.

Në këtë webinar, u veçuan hapat drejt rimëkëmbjes së industrisë së turizmit si dhe impaktin që kjo pandemi ka sjellë në Shqipëri dhe në Evropë, si dhe masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për mbrojtjen e këtij sektori, impaktin në agjencitë turistike, hoteleri dhe udhëtimet ajrore dhe atë çfarë premtom e ardhmja për këtë sektor. Për më tepër ju ftojmë të ndiqni regjistrimin e webinarit në linkun:

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/908900012950339>



Guidë rreth Statusit Eksportuesi i Miratuar

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi në datën 16 Korrik webinarin me temë: Guidë për statusin “Eksportuesi i Miratuar”.

Z. Genc Çeli, Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit | AIDA, mbajti webinarin rreth statusit “Eksportuesi i Miratuar”. Gjatë këtij webinarit Z. Çeli prezantoi te eksportuesit shqiptarë informacionin për disa lehtësira që parashikon legjislacioni doganor në fushën e origjinës së mallrave dhe përfitimet që ka biznesi eksportues nga këto lehtësira.

Webinari vijoi me një bashkëbisedim të vlefshëm mes palëve pjesëmarrëse lidhur me pyetjet dhe qëndrimet e tyre kundrejt temës.

Për më shumë informacion ndiqni video regjistrimin e webinarit në linkun: <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/1163344064049113>



Ditë informuese EEN - Albania | Sipërmarrjet Shqiptare pjesë e familjes evropiane”.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e koordinatorës së EEN - Albania, organizoi në datë 30 Korrik webinarin me temë: “Ditë informuese EEN - Albania | Sipërmarrjet Shqiptare pjesë e familjes evropiane”.

Ky webinar kishte si qëllim të informonte të gjitha bizneset shqiptare mbi mundësitë që Enterprise Europe Network (EEN - Albania) ofron për gjetjen e partnerëve të biznesit, zhvillimin e inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë në tregun European e më gjerë.

Webinari ju vjen në ndihmë të gjitha sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por edhe bizneseve të tjera, universiteteve dhe qendrave kërkimore që duan të zhvillohen në tregje të reja ndërkombëtare dhe që kërkojnë akses në financë. Për më tepër ju ftojme të ndiqni video regjistrimin e webinarit në linkun: <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/290030652065220>



Guidë mbi grantet Europiane për Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Enterprise Europe Network -Albania organizuan në datë 17 Shtator webinarin me temë: “Guidë mbi grantet Europiane për SME-të”

Ky webinar kishte si qëllim informimin e bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare mbi ekzistencën e mjeteve, portaleve dhe programeve të ndryshme europiane të cilat janë në mbështetje të zhvillimit të biznesit.

Webinari ju vjen në ndihmë të gjitha bizneseve, të cilat kanë nevojë të informohen mbi tregun european dhe mundësitë e shumta që ai ofron, si edhe për orientimin e bizneseve drejt mundësive të financimit të nevojave dhe projekteve të tyre. Për më tepër informacion ndiqni video regjistrimin e webinarit në linkun: <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/327912981993309>



RUBRIKA | WEBSITE

Platforma “Business to Business”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), bëri publike këtë periudhë platformën B2B në ndihmë të NVM-ve.

Platforma B2B është një rrjet aktiv i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve.

Platforma B2B që është e bashkëlidhur në faqen e AIDA-s është një mjet lehtësues, ku bashkëpunimet frytdhënëse dhe zgjerimi i kontakteve në botën e biznesit do të vazhdojë të jetë i mundur pa humbur më shumë kohë.

AIDA ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

Për t'u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

PLATFORMA BUSINESS TO BUSINESS

BËHU PJESË!
REGJISTRO BIZNESIN TËND

Na kontaktoni në e-mail: info@aida.gov.al

www.aida.gov.al

AIDA
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

invest in Albania

Rubrika COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve, prezantoi rubrikën më të re në web-in zyrtar: www.aida.gov.al “COVID-19”.

Në këtë rubrikë prezantohen iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të përballuar situatën, informacione të përditësuara në lidhje me paketat financiare në ndihmë të biznesit, aplikimet për programet e mbështetjes së biznesit, projektet, nismat e tjera publike, si edhe lidhje e kontakte të rëndësishme.

Kjo rubrikë ka si qëllim aksesin në informacion dhe qarkullimin e këtij informacioni në një kohë sa më të shpejtë për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u njohur me informacionet e publikuara në këtë rubrikë vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



COVID-19



PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

Miratohet paketa e re me lehtësira fiskale për biznesin në vitin 2021

U miratua nga kuvendi vendimi për heqjen e tatim-fitimit për bizneset me xhiro deri në 14 mln lekë dhe gjithashtu heqjen e TVSH-së për bizneset me xhiro deri 10 mln lekë.

Në prezantimin e kësaj pakete të re fiskale u theksua se ky është një vazhdim i masave të ndërmarra nga qeveria shqiptare si pasojë e pandemisë COVID-19.

Biznesi i vogël është ndihmuar nga qeveria shqiptare tashmë me ulje të procedurave, barrës fiskale, dhe është konkretizuar me rritjen e fitimit. Nga miratimi i këtij vendimi pritet të përfitojë 77% e sipërmarrjes në vend.



AIDA publikon informacionin e plotë dhe të përditësuar mbi masat e marra për sektorin e turizmit dhe udhëtimit në Shqipëri

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në kuadër të situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve prezanton një përmbledhje me masat e marra për sektorin e turizmit dhe udhëtimit në Shqipëri.

Në këtë përmbledhje prezantohen paketat financiare, aktet normative dhe masat përkatëse të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në sektorin e turizmit si pasojë e pandemisë COVID-19.

Për më shumë informacion klikoni linkun: <http://aida.gov.al/.../Masat%20e%20COVID-19%20per...>



COVID-19

Lista me botime dhe informacione të botuara nga UNCTAD

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ju njeh me listën e botimeve, dokumenteve, videove dhe podcast-eve të ndryshme të botuara nga UNCTAD gjatë periudhës së COVID-19.

Në këtë listë botimesh do të gjeni informacione dhe analiza mbi ndikimin e pandemisë në fusha të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë globale ashtu edhe të sektorëve specifik.

Këto informacione të përditësuara i dedikohen dhe janë për dijeni të të gjitha bizneseve dhe palëve të interesuara për t'u njohur me zhvillimet më të fundit të pandemisë, në kuadër edhe të zhvillimit të veprimtarisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/.../UNCTAD%20-%20News,%20Analysis...>



COVID-19

Programi Power Up- Ndërtimi i Kapaciteteve për SME-të dhe Start Up në Ballkanin Perëndimor

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njofton se Banka Botërore ka iniciuar një program “PowerUP, Ndërtimi i Kapaciteteve për SME-të dhe Start Up në Ballkanin Perëndimor”, i cili do të ofrohet pa pagesë.

Programi do të ofrojë ndihmë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së kompanisë suaj, përshtatjen e modelit tuaj të biznesit dhe rritjen në treg. Kompanitë e përzgjedhura do të marrin trajnim falas mbi ndërtimin e kapaciteteve që synojnë mbështetjen e rezistencës së tyre ndaj COVID-19, perspektivat e rritjes dhe rritjen e gatishmërisë për investime. Kompanitë që do të pranohen në program duhet të jenë inovative, të kenë 3-100 të punësuar dhe të kenë një produkt ose një shërbim që gjeneron të ardhura në të paktën një treg. Aplikoni deri më 30 shtator 2020, duke plotësuar formularin e aplikimit në linkun e mëposhtëm: <https://www2.deloitte.com/.../program-per-ndermarrjet-e...>

Për më shumë informacion na kontaktoni në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

POWER UP.
Growth program for SMEs and startups in the Western Balkans.

 Funded by the European Union under the Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility
 **WB EDIF**
Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility
 **THE WORLD BANK**
 **Deloitte.**



SHFLETO BROSHURAT E REJA TË AIDA-S

BOTIME

Fletëpalosje “Helping ambitious SME’s innovate and grow internationally”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e institucionit koordinues të Enterprise Europe Network - Albania (EEN - Albania), ju njeh me botimin më të ri “Helping ambitious SME’s innovate and grow internationally”

Ky botim përmban një përmbledhje me informacione mbi mundësitë dhe shërbimet e integruara që EEN-Albania ofron për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, me synim rritjen e aftësive konkurruese dhe inovative, si edhe krijimin e partneriteteve të reja në tregun Europian e më gjerë.

AIDA dhe EEN-Albania nëpërmjet shërbimeve, asistencës teknike, këshillimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare do të vazhdojnë të mbështesin bizneset shqiptare që të jenë konkurruese dhe inovative, si edhe të zgjerojnë biznesin e tyre nëpërmjet gjetjes së partnerëve të rinj.

Impakti i COVID-19 në sektorin e turizmit në botë

Pandemia e koronavirusit (COVID-19) ka pasur ndikim në shëndetin publik, por gjithashtu ka prekur rëndë një nga industritë kyçe të ekonomisë ndërkombëtare - industrinë e turizmit. Linjat ajrore po shohin një rënie masive të pasagjerëve, degë të tjera të industrisë së turizmit po përballen me pengesa të ngjashme. Në vitin 2020, të ardhurat globale nga industria e udhëtimit dhe turizmit ishin parashikuar të shkonin në 711.94 miliardë dollarë por kjo shifër është ulur në 568.6 miliardë dollarë, që paraqet një rënie mbi 20%.

Si pika e origjinës së përhapjes së koronavirusit, rajoni i Azisë është më i prekuri nga COVID-19. Degët që janë parashikuar të shohin rënien më të lartë të shpenzimeve janë restorantet dhe baret (ushqimi dhe pije) dhe transporti.

Italia mund të humbasë deri në 7.7 miliardë euro në vlerë të shtuar të turizmit këtë vit. Në Spanjë, numri me i madh i anulimeve të hoteleve ka ndodhur gjatë Pashkëve, duke detyruar shumë kompani hotelesh të mbyllin dyert e tyre përkohësisht. Në Paris, një nga qytetet më të vizituara në të gjithë botën, nivelet e okupimit të hoteleve kanë rënë nga 84% në Janar 2020, me 1.8% në Mars.



Rriten me 11.6% eksportet e bujqësisë në Shqipëri pavarësisht kushteve të pandemisë

Fermerët shqiptarë edhe pse në kushtet e pandemisë botërore COVID-19 kanë rritur me 11.6% sasinë e frutave dhe perimeve të eksportuara gjatë periudhës Janar- Qershor 2020.

112,000 tonë fruta dhe perime u eksportuan gjatë kësaj periudhe me një vlerë prej 6.4 miliardë lekësh.

Në periudhën janar-maj 2020 vlera e eksportit të bimëve medicinale ishte rreth 1.7 miliardë lekë, duke ruajtur trendin në rritje.





ANKETIM

AIDA prezanton anketën mbi impaktin e COVID -19 në Sektorin e Turizmit Shqiptar

Anketa është realizuar me operatorët më të rëndësishëm në sektorin e turizmit si agjencitë turistike dhe operatorët turistikë, për t'u njohur më shumë me problematikat që po has ky sektor në Shqipëri gjatë kësaj periudhe.

Në vijim janë realizuar dhe një numër telefonatash me disa shoqata biznesi që përfaqësojnë zërin e këtij sektori, të cilat kanë përcjellë problematikat e raportuara, duke ofruar gjithashtu sugjerime konkrete që mund të lehtësojnë dhe ndihmojnë rimëkëmbjen e rrjetit të operatorëve dhe vetë turizmit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë për ekonominë mbarëbotërore.

Kjo urë komunikimi ka shërbyer njëkohësisht që sektori i përkujdesjes ndaj investitorëve t'i komunikojë bizneseve elektronikisht edhe paketën për marrjen e masave të përkohshme në sektorin e turizmit.

Për t'u njohur me gjetjet e anketës konsultoni raportin "Impakti i COVID -19 në Sektorin e Turizmit Shqiptar", duke vizituar linkun:

http://aida.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Impakti-i-COVID-19-ne-sektorin-e-turizmit.pdf?fbclid=I-wAR1UVD1_TJIE7yCOvHjBUcdwWWWn_-LUUbNUMQX0xd1E_-z8o1HKr9G4kRo

AIDA
invest in Albania

ANKETIM


IMPAKTI I COVID-19 NË SEKTORIN E TURIZMIT SHQIPTAR

REZULTATET E ANKETIMIT TË AIDA-S NË AGJENCITË DHE OPERATORËT TURISTIK NË SHQIPËRI

AIDA
invest in Albania

SUGJERIME NGA BIZNESET:


1. STIMULIMI FINANCIAR I TUR-OPERATORËVE TË HUAJ DHE/OSE ATYRE VENDAS PËR SJELLJEN E ÇDO TURISTI TË HUAJ NË SHQIPËRI PËR NJË MINIMUM PREJ 4 NETË AKODIMI NË STRUKTURAT AKODUESE SHQIPTARE
2. MBËSHETJE NGA QEVERIA ME PAGESA TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR BIZNESET TURISTIKE ME PROFIL SEZONAL
3. TË PËRFITONJË NGA PAKETA FINANCIARE PUNONJËSIT E TUR-OPERATORËVE INCOMING & OUTGOING, PJESË E BIZNESIT TË MADH
4. TË RISHIKOHET VAZHDMI I MBËSHETJES FINANCIARE NGA SHTETI PËR PUNONJËSIT QË JANË LARGUAR NGA PUNA
5. PAGAT PËR PUNONJËSIT TË JEPEN PËR NJË PERIUDHË DERI NË FILLIMIN E PAKUFIZUAR TË FLUTURIMEVE DHE HAPJEN E PLOTË TË KUFIJVE AJRORË/TOKESORË/DETARË



AIDA
AGJENCIA SHQIPTARE E INVESTICIONEVE
INVEST IN ALBANIA

SUGJERIME NGA BIZNESET:

6. MASA STIMULUESE PËR TURISTËT NGA RAJONI ME QËLLIM NXITJEN E BËRJES SË PUSHIMEVE NË SHQIPËRI
7. RIMBURSIMI I TVSH-SË, PËR TË GJITHË BIZNESET E SEKTORIT TË TURIZMIT QË KANË TVSH KREDITORE
8. HARTIMI I NJË PAKETE INFORMUESE MBI KRITERET E VECANTA TË UDHËTIMIT NË PERIUHDËN E PANDEMISË
9. RISHIKIMI I DETYRIMIT DHE SANKSIONEVE TË PARASHIKUARA PËR OPERATORËT TURISTIKË DHE AGJENCITË E UDHËTIMIT
10. PROPOZOHET RIKTHIM I TATIM FITIMIT TË PAGUAR PËR VITIN 2018 SI NJË FORMË NDIHME FINANCIARE (QË SUBJEKTET TË KENË MUNDËSI TË PLOTËSOJNË NJË PJESË TË HUMBJEVE NGA OFERTAT E PARAPAGUARA) OSE HEQJA E DETYRIMIT PËR TË PAGUAR TATIM FITIMIN PËR VITIN 2019



AIDA
AGJENCIA SHQIPTARE E INVESTICIONEVE
INVEST IN ALBANIA

MASAT E NDËRMARRA NGA QEVERIA TË CILAT JANË VLERËSUAR SI MË POZITIVET NGA BIZNESET:

1. SHTYRJA E PAGESAVE MBI TATIM FITIMIN PËR VITIN 2019
2. MASAT E VECANTA PËR OPERATORËT TURISTIKË, AGJENCITË E UDHËTIMIT DHE KLIENTËT
3. PAGA E LUFTËS

ENERGJIA DHE NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË SEKTORIN ENERGETIK



SEKTORI ENERGETIK NË SHQIPËRI

Energjia dhe integrimi në tregjet ndërkombëtare energjetike përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit dhe integritit të vendit tonë në BE. Shqipëria është palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që prej vitit 2006. Vendi ynë varet 95% në energjinë hidrike, duke qenë pothuajse në varësi të plotë të zhvillimeve të motit. Në furnizimin primar me energji bën pjesë gjithashtu nafta dhe energjia elektrike e importuar.

Paqëndrueshmëria e motit, thatësira që karakterizoi pjesën më të madhe të vitit 2019 - situatë e cila pritet të vazhdojë dhe në vitet e ardhshme - kanë theksuar më shumë nevojën për diversifikim të burimeve energjetike. Prurjet mesatare të ujit në basenet e HEC-eve ishin 119 m³/s, ose 34% më pak se mesatarja shumëvjeçare, që nga viti 1991, çka në funksion të furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve, rriti sasinë e energjisë së importuar.

Falë pozitës së favorshme gjeografike në Basenin e Detit Mesdhe, Shqipëria posedon burimet për investime madhore në energjinë hidrike, diellore dhe të erës. Përdorimi i këtyre burimeve lidhet me tre objektiva të politikave të energjisë si: mbështetja për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rritja e sigurisë energjetike dhe mbrojtja e mjedisit. Energjia e rinovueshme mund të jetë zgjidhja për reduktimin e varësisë strategjike në importe dhe jo vetëm për sigurinë energjetike, por dhe për sigurinë politike dhe makroekonomike të vendit. Prej muajit Maj 2019 Shqipëria ka bursën e saj të energjisë, në të cilën deri tani janë regjistruar 30 kompani. Krijimi i Bursës Shqiptare të Energjisë është një nxitje për hapjen dhe derregullimin e tregut të energjisë elektrike si dhe do të inkurajojë instalimin e burimeve të reja energjetike, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, integrimin rajonal dhe më gjerë të këtij tregu, rritjen e investimeve në sektor, më shumë transparencë financiare, si dhe standarde të reja përgjegjësie juridike dhe tregtare.

Në territorin e Shqipërisë ka një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore, ku shumë prej zonave të Ultësirës Perëndimore janë të ekspozuara ndaj një rrezatimi që arrin nga 1185 kWh/m² në vit deri në 1700 kWh/m² në vit. Në mot të kthjellët, këto zona mund të thithin rreth 2200 kWh/vit. Aktualisht janë 8 kompani me instalime fotovoltaike në zona të ndryshme të vendit, me një kapacitet të instaluar prej 15 MW, kryesisht për përdorim lokal dhe të kufizuar. Për vitin 2019 këto instalime prodhuan 22,190 MWh, duke ndryshuar kështu deri diku panoramën e sektorit energjetik në Shqipëri. Projekti i Parkut Fotovoltaike të Karavastasë (140 MW), me fitues kompaninë franceze Voltalia, pritet të ristrukturojë sektorin, duke vendosur standartet për projektet e ardhshme të këtij kapaciteti si dhe duke bërë të mundur diversifikimin e burimeve energjetike. Ky projekt realizohet në përmbushje të angazhimit të shtetit shqiptar për të prodhuar 42% të energjisë së përgjithshme nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2030. Gjithashtu relievi i larmishëm favorizon prodhimin e energjisë elektrike nga era. Gjatësia e bregdetit në drejtimin veri-jug është rreth 345 km brenda territorit dhe intensiteti varion nga zona në zonë.

Siç dihet, Shqipëria është e dyta në Europë për rezervat e ujit dhe ka një rrjet shumë të pasur hidrik. Vendi ynë ka një kapacitet hidrik prej 1466 MW. Prej këtij potenciali vetëm 35.4% përdoret aktualisht. Territori hidrografik shqiptar është rreth 44.000 km² me një prurje mesatare prej 1245m³/sek. Krahas hidrocentralëve ekzistues si Banja-Devoll, Kalivaç, Bistrica I dhe Bistrica II, një nga projektet ambicioze është ndërtimi i Skavicës në kaskadën e Drinit me një prurje prej 96 m³/sek, i cili është vazhdimësi e projektit të vitit 1960. Synohet që Skavica të sigurojë optimizimin e 3 hidrocentralëve ekzistues deri në 80 MW dhe sipas studimit të kompanisë Tractebel Engie, do të ofrojë një zgjidhje për përmbytjet e Fushë-Lezhës dhe Fushë-Shkodrës.

Ndryshe nga vendet e rajonit, Shqipëria është prodhuese dhe eksportuese e naftës bruto, me rezerva që vlerësohen në 1.4 mln ton/vit ose 500 mln fuçi.

Aktualisht janë 17 vendburime të naftës bruto, 7 në shtresa ranore dhe 10 në gëlqerore. Investimet në kërkimin dhe eksplorimin e naftës dhe gazit, vitet e fundit llogariten në 1.25 miliardë €, ku 1/3 e tyre është investuar direkt nga Shell Upstream Company, e cila është aktive në tregun shqiptar prej 6 vitesh, duke synuar investime të tjera shtesë pas një zbulimi shumë pozitiv në fushën e naftës Shpiragu-2. Sipas të dhënave, Bankers Petroleum, përbën shumicën dërrmuese prej 89% të prodhimit të përgjithshëm vendas. Vendi ynë është pjesë e Rrjetit Gazsjellës TransAdriatik (TAP) i cili do të transportojë gaz natyror nga Azerbajxhani në Detin Kaspik, duke filluar nga Greqia, përmes Shqipërisë dhe Detit Adriatik, në Itali.

NDIKIMI I PANDEMISË NË SEKTORIN ENERGETIK

Pandemia e COVID-19 ka krijuar ndoshta krizën më të madhe globale të të gjitha kohërave. Përballë kësaj situatë të paprecedentë, qeveritë janë fokusuar te vendosja nën kontroll e përhapjes së infeksionit dhe rigjallërimi i ekonomive respektive. Gjatë muajve të karantinës, masat e ndërmarra në funksion të ndërprerjes së infeksionit e kanë reduktuar mjaft kërkesën për furnizim me energji elektrike. Sipas të dhënave të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, kërkesa botërore për furnizim me energji elektrike u ul me 2.5% në katërmujorin I të 2020 . Kërkesa e ulët do vazhdojë të ulë çmimin e naftës, prej të cilit mund të përfitojnë shtetet importuese. Mirëpo nga ana tjetër, mbyllja e aktiviteteve ka sjellë pastrimin e ajrit, duke e ulur ndjeshëm emetimin e CO2 në hapësirat urbane. Gjithashtu dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme gjatë kësaj periudhe u rrit me 3% . Qëndrueshmëria e energjisë së rinovueshme në këto rrethana siguron optimizëm të fortë për rritjen e kërkesës dhe investimet në këtë sektor. Zinxhiri i furnizimit me energji elektrike ka hasur problem jo vetëm për shkak të kërkesës së ulët, por dhe për shkak të mbylljes së përkohshme të kompanive të pajisjeve dhe komponentëve të energjisë elektrike. Masat që u ndërmorrën për të përballuar problemet e menjëhershme, nga shumë shtete ishin moratorium për pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe deklarimi i force majeure për të fuqizuar sektorin. Ndërsa në Shqipëri, u siguroi furnizimi i pandërprerë me energji elektrike përgjatë gjithë periudhës së karantinës. Një nismë pozitive e Qeverisë Shqiptare ishte pagesa e energjisë elektrike edhe gjatë kësaj kohe, pasi kjo siguroi vazhdimësinë e aktiviteteve në tërësi. Mbyllja e përkohshme e kompanive me numër të konsiderueshëm punonjësish, sigurisht ndikoi në uljen e kërkesës për furnizim me energji elektrike. Kjo rezultoi në uljen e importit të energjisë bruto me 25% nga tremujori I në tremujorin II 2020. Prodhimi i hidrocentraleve gjithashtu pësoi rënie me 23%. Humbjet në shpërndarje u zvogëluar me 47%, kjo dhe për shkak të konsumit më të ulët. Sektori i energjisë së rinovueshme edhe pse ende në fillesa, shënoi rritje të prodhimit me 65% nga T1 në T2 , si për të përforcuar hipotezën se pandemia nuk e ka prekur këtë sektor, madje e ka favorizuar. Rihapja e aktivitetit të kompanive dhe bizneseve pritet të rrisë kërkesën dhe prodhimin e energjisë elektrike në muajt në vazhdim, duke zbutur efektet e menjëhershme në sektor.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sektori energjetik në Shqipëri është kontribuesi kryesor në zhvillimin e vendit dhe sektor prioritar, kjo dhe për shkak të pasurive të mëdha tokësore dhe nëntokësore. Këtë vit, rrjeti gazsjellës TAP pritet të nisë funksionimin dhe Shqipëria përpos përfutimit të një sasie të gazit, pozicionohet mjaft mirë dhe në hartën gjeoenergjetike europiane si vendkalim i rëndësishëm i gazit azer. Mbivarrësia në energjinë hidrike kohë pas kohe po e vë në dukje nevojën e madhe për burime sekondare të energjisë. Vendi ynë, me rreth 300 ditë me diell në vit dhe relief të larmishëm ofron një potencial, të cilin Shqipëria ka filluar ta shfrytëzojë në bazë të kërkesave të vazhdueshme të investitorëve. Pranë AIDA-s projektet të cilat aplikojnë për statusin e investitorit strategjik i përkasin vlerave të investimit mbi 84 milion € deri në 350 milion €, çka tregojnë një interes të vazhdueshëm për investime në këtë sektor. Një sugjerim i vlefshëm në këtë aspekt, do të ishte shfrytëzimi i tokave të papunueshme, me bonitet VIII, IX, X për instalime impiantesh fotovoltaike. Si sektor relativisht i ri, Projekti i Parkut Fotovoltaike të Karavastës mund të jetë një nxitës shumë pozitiv për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues për burimet e rinovueshme të energjisë, duke shërbyer si precedent dhe standart për projektet e ardhshme si dhe duke i dhënë prioritet investimeve të mëdha mbi 50 MW. Baza ligjore sektoriale me Ligjin Nr.7/2017VKM Nr.480, datë 31.7.2018; VKM Nr.179, datë 28.3.2018 dhe sidomos VKM Nr.349, datë 12.6.2018 po krijojnë infrastrukturën e duhur për zhvillimin e energjisë së rinovueshme. Për vitin 2019 hartës së lokacioneve me potencial për energjinë eolike i shtohen dhe zona si Gllava, Xarra dhe Sheqerasi . Një incentivë e sugjeruar për t'i dhënë hov instalimeve eolike do të ishte përjashtimi nga TVSH-ja për makineritë dhe pajisjet që përdoren në prodhimin e energjisë elektrike nga turbinat e erës, incentivë e cila deri tani është aplikuar vetëm për impiantet fotovoltaike.

1 <https://www.energy-community.org/>

2, 6, 9, 15 AKBN, 2019

3 Enti Rregullator i Energjisë, Raporti Vjetor 2019 4

4 www.monitor.al

5 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

7 Ibid.

8 VKM Nr.480, datë 31.07.2018

10 www.altax.al

11 IEA, 2020

12 IFC, 2020

13 Klauzolë që lejon kontratat të deklarohen null ose të pavlefshme për shkaqe mbinatyrore ose rrethana të paparashikuara

14 INSTAT



EVENTE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) promovon rritjen e pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve e të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja, për të ndihmuar rritjen e dimensioneve të tyre edhe në nivel ndërkombëtar.

Eventi ndërkombëtar “Good Trade Summit”

<https://www.intracen.org/good-trade-summit/>



Zhvillohet Edicioni i 5-të i Javës së Modës “Torino Fashion Week 2020”

<https://torino-fashionmatch-2020.b2match.io/>



Istanbul Fintech Week 2020 Matchmaking Event

<https://ifw2020.b2match.io/home>



InnoVision Ecosystem Awards 2020, Tel Aviv

<https://globalinnovision.com/>



BUD-GRYF & HOME Fair 2020, Virtual Matchmaking event

<https://budgryf2020.b2match.io/>



Eventi ndërkombëtar “Slovak Matchmaking Fair 2020”.

<https://sario.sk/en/events-projects/slovak-matchmaking-fair-bratislava-2020-0?fbclid=IwAR1kIKXsqf9X1CxeR-3CFIMYpAij7v7nasCYIIGTpZ6ACUoFvzt0qhnlyXkQ>



Eventi “R&D Innovation Conference”

<https://rndconf.com/>





invest in Albania

